



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2022:050126

Datë: 29.03.2024

Numri i dokumentit: 05525498

KPPP.nr.1993/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e shkallës së parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtarja Vera Gashi Bala, në çështjen përmbareme të kreditorit Sh.P.K., “Panther” me numër të regjistrimit të biznesit 71164616 dhe seli në Prishtinë, përfaqësuar nga K.R. dhe V.Zh., avokatë në Prishtinë, kundër debitorit “Bechtel-Enka GP” me numër unik identifikues 810897712 dhe seli në Prishtinë, rr. “Mujo Ulqinaku” 5/9, kati 4, përfaqësuar nga G.V., avokatë në Prishtinë, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbareme P.nr.52/22 të datës 01.02.2022 i lejuar nga Përmbaremi Privat Gjokë Radi, me seli të zyrës në Gjakovë, jashtë seancës, me datë 29.03.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. REFUZOHET I PABAZUAR prapësimi i debitorit “Bechtel-Enka GP” me seli në Prishtinë, i ushtruar ndaj Urdhrit Përmbareme P.nr.52/22 të datës 01.02.2022 i lejuar nga Përmbaremi Privat Gjokë Radi.
- II. MBETET NË FUQI Urdhrit Përmbareme P.nr.52/22 të datës 01.02.2022 i lejuar nga Përmbaremi Privat Gjokë Radi.

A r s y e t i m

Përmbaremi Privat Gjokë Radi, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit, ka lëshuar urdhrin përmbareme P.nr.52/22 të datës 01.02.2022 me të cilin ka lejuar përmbaremin, në bazë të dokumentit të besueshëm, faturave me nr. F1100391 të datës 30.11.14, F01200391 të datës 13.12.14, F00100391 të datës 01.02.15, F00200391 të datës 28.02.15, F00300391 të datës 31.03.15, F0400362 të datës 30.04.15, F00500391 të datës 31.05.15, F00600391 të datës 30.06.15, F00700391 të datës 31.07.15, F00800391 të datës 31.08.15, F00900391 të datës 30.09.15, F1000391 të datës 31.10.15, F1100391 të datës 30.11.15, F1200391 të datës 31.12.15,

F00100391 të datës 31.01.16, F00200391 të datës 29.02.16, F00300391 të datës 31.03.16, F00400391 të datës 30.04.16, F00500391 të datës 31.05.16, F00600391 të datës 30.06.16, F00700391 të datës 31.07.16, F00800391 të datës 31.08.16, F00900391 të datës 30.09.16, F01000391 të datës 31.10.16, F01100391 të datës 30.11.16, F01200391 të datës 31.12.16, F00100391 të datës 31.01.17, F00200391 të datës 28.02.17, F00300391 të datës 31.03.17, F00400391 të datës 30.04.17, F00500391 të datës 31.05.17, F00600391 të datës 30.06.17, F00700391 të datës 31.07.17, F00800391 të datës 31.08.17, F00900391 të datës 30.09.17, F1000391 të datës 31.10.17, F1100391 të datës 30.11.17, F1200391 të datës 31.12.17, F00100391 të datës 31.01.18, F00200391 të datës 28.02.18, F00300391 të datës 31.03.18, F00400391 të datës 30.04.18, F00500391 të datës 31.05.18, F00600391 të datës 30.06.18, F00700391 të datës 31.07.18, F00800391 të datës 31.08.18, F00900391 të datës 30.09.18, F01000391 të datës 31.10.18, F01100391 të datës 30.11.18, F01200391 të datës 31.12.18, F0101033 të datës 31.01.19, F0201033 të datës 28.02.19, F0301033 të datës 31.03.19, F0401033 të datës 30.04.19, F0501033 të datës 31.05.19, F0601033 të datës 30.06.19, F0701033 të datës 31.07.19, F0801033 të datës 31.08.19, F0901033 të datës 30.09.19, F1001033 të datës 31.10.19, F1101033 të datës 30.11.19, F1201033 të datës 31.12.19, dhe F0101033 të datës 31.01.20, duke urdhëruar debitorin që në emër të borxhit nga faturat e mësipërme t'ia paguaj kreditorit shumën prej 47,493.17 € me kamatë ligjore 8% në vit dhe atë në afat prej 7 ditëve nga dita e pranimit të urdhrin për lejimin e përmbarrimit, e të bëjë pagesën e plot të borxhit dhe shpenzimeve përmbarrimore.

Debitori në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor, ka kundërshtuar në tërësi urdhrin përmbarrimor duke theksuar se palët kanë zgjedhur arbitrazhin ndërkombëtar si mekanizëm për zgjedhjen e kontesteve të tyre dhe pa paragjykuar vlerësimin e gjykatës lidhur me shkaqet tjera të këtij prapësimi, thekson se ky prapësim do të duhej të aprovohej vetëm mbi këtë bazë dhe se Gjykata do të duhej të anuloi Urdhrin Përmbarrimor dhe veprimet të tjera procedurale dhe të shpallet inkompetent për vendosje lidhur me këtë çështje. Tutje thekson se kërkesa që rrjedh nga faturat e ofruara nga kreditorit, para datës 1 shkurt 2019, në kuptim të nenit 355 të LMD-së është parashkruar, pra faturat e tilla, nuk mund të jenë objekt i përmbarrimit për shkak se ka kaluar periudha tre vjeçare e paraparë me dispozitat e LMD-së. Më tej ka shtuar se faturat e lëshuara në lidhje me dëmet e pësuar si rezultat i vjedhjeve dhe dëmtimeve në pajisjet dhe makineritë e tij, e që për to ishin përpiluar raporte të përbashkëta e të nënshkruara nga të dy palët, njofton Gjykatën se vlera e këtyre faturave të përputhshme në përpikëri me ato raporte, arin në lartësi prej 47,492.21 €, pra është vlera identike me vlerën të cilën kreditori kërkon në këtë procedurë

përmbarimore nga debitori. Shton se ai ka përmbushur në tërësi të gjithë obligimet që kanë rrjedhur nga faturat e lëshuara nga kreditori. Gjykatës i ka propozuar që të aprovoj në tërësi si të themeltë prapësimin, të shfuqizohet Urdhri Përmbarimor dhe të detyrohet kreditori që t'i paguaj shpenzimet përmbarimore, si dhe shpërblimin e avokatit për përpilimin e prapësimin në vlerë prej 156.00 €.

Kreditori brenda aftit ligjor ka paraqitur përgjigje në prapësim, duke kundërshtuar në tërësi pretendimet e debitorit të paraqitura në prapësim, thekson se përmbarimi është lejuar në bazë të faturave origjinal të lëshuara nga kreditori, e të cilat fatura janë të nënshkruara dhe të konfirmuara nga debitori të cilat burojnë nga bashkëpunimi i tyre lidhur me sigurimin e pajisjeve të cilat kanë operuar në Kosovë, të cilat fatura debitori i kishte pranuar në mënyrë të rregullt për përmbushje vullnetare. Tutje thekson se përmbaruesi privat ka qenë kompetent për ekzekutimin e faturave, për faktin se shërbime janë kryer në Republikën e Kosovës. Më tej thekson se palët ishin pajtuar se Arbitrazhi Ndërkombëtar do të jetë kompetentë për zgjidhjen e kontesteve vetëm në rastet kur kemi të bëjmë me çështje kontestuese, ndërsa në rastin konkret kemi të bëjmë me faturat të rregullta të cilat janë pranuar nga debitori. Shton se debitori nuk i ka paguar obligimet ndaj tij, po të i kishte paguar detyrimet sipas faturave atëherë një gjë e tillë do të mund të vërtetohej sipas transaksioneve bankare, të cilat debitori nuk i ka paraqitur si prova, për faktin se debitori nuk e ka përmbushur detyrimin sipas faturave me të cilat është lejuar përmbarimi. Po ashtu thekson se faturat burojnë nga kontrata e lidhur ndërmjet palëve të cilës kontratë i referohet edhe vet debitori, andaj duke u nisur nga fakti se në rastin konkret ka të bëjë me kontratën e cila është e lidhur pa afat të caktuar kohë, në këtë rastin nuk ka të bëjë me parashkrim të borxhit. Gjykatës i ka propozuar që ta refuzoj në tërësi prapësimin, Urdhrin Përmbarimor të lë në fuqi dhe të obligohet debitori që t'i kompensoj kreditorit të gjitha shpenzimet e shkaktuara në këtë procedurë.

Gjykata, pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, pretendimeve të kreditorit në përgjigje në prapësim dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore, gjeti se prapësimi i debitorit është në tërësi i pabazuar andaj, të njëjtin e refuzoi dhe vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi, për shkaqet si në vijim:

Sipas nenit 29, paragrafi 1 i LPP-së, "*Përmbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm*", ndërsa, pika 1.3 e të njëjtit nen përcakton faturën si dokument i besueshëm sipas të cilës mund të caktohet përmbarimi për

realizimin e kërkesës në të holla. Tutje, sipas paragrafit 3, të nenit 29 të LPP-së, *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbartim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”*, ndërsa, sipas nenit 37 të LPP-së: *“Kur propozimi për përmbartim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit”*.

Me këtë rast, gjykata ka konstatuar se urdhri i dhënë nga Përmbartuesi Privat është i mbështetur në dokumentin e besueshëm - faturat, të cilat i plotësojnë të gjitha kushtet për të qenë dokument i besueshëm dhe i përmbajnë të gjitha elementet e kërkuara në përputhje me nenin 29 paragrafi 1.3 të LPP-së, kjo pasi që në fatura janë treguar palët, përkatësisht kreditori dhe debitori, janë emërtuar mallrat me të cilat është shërbyer debitori, është përcaktuar shuma e cila është detyrim për përmbushje nga ana e debitorit. Gjithashtu, faturat mbi bazën e së cilave është lejuar urdhri përmbartimor janë pranuar me rregull nga ana e debitorit ngase të njëjtat mbajnë nënshkrimin e debitorit.

Gjykata pati parasysh pretendimet e debitorit por pretendimet e tilla nuk i morri për bazë për faktin se ato mund të realizohen në procedurë civile, por gjeti se faturat në bazë të cilës është lejuar përmbartimi i plotësojnë kushtet ligjore për të qenë dokument i besueshëm, edhe për faktin se janë pranuar nga Debitori, ndërsa nuk janë kundërshtuar asnjëherë në ndonjë aspekt nga ai.

Gjithashtu, gjykata vlerëson se në rastin konkret faturat mbi bazën e së cilave është lejuar urdhri i plotësojnë kushtet e përcaktuara në nenin 37 të LPP-së, për zbatimin e përmbartimit në bazë të dokumentit të besueshëm, pasi që të njëjtat janë dorëzuar në origjinal.

Sa i përket pretendimit të debitorit se faturat tashmë janë parashkruar, gjykata sqaron se borxhi i kërkuar nuk mund të konsiderohet si borxh për faturat që mund të jenë parashkruar, kjo gjithnjë duke u bazuar në nenin 293 të LMD-së për llogaritjen e radhës së përmbushjes, i cili në para. 1 ka rregulluar se *“Kur midis personave të njëjtë ekzistojnë disa detyrime të njëjllota, kështu që atë që debitori e përmbush nuk mjafton për t’i plotësuar të gjitha, atëherë, në qoftë se për këtë gjë nuk ekziston marrëveshja e kreditorit dhe debitorit, llogaritja bëhet me atë radhë të cilën e cakton debitori më së voni me rastin e përmbushjes”*, ndërsa para. 2 i të njëjtit nen ka paraparë se *“Kur nuk ekziston deklarata e debitorit mbi llogaritjen, atëherë detyrimet përmbushen me radhë ashtu sikurse kanë arritur për përmbushje”*. Prandaj, meqë mes palëve nuk kishte marrëveshje e cila e rregullonte radhën e përmbushjes në rast të dy a më shumë detyrimeve të

njëllojta, ndërsa nuk ka dëshmi se Debitori e ka caktuar radhën e detyrimit, përkatësisht se cilin detyrim do të përmbush, atëherë gjykata pjesën e paguar të borxhit e konsideron si pagesë për faturat që mund të jenë parashkruar, ndërsa borxhi i mbetur të llogaritet për faturat të cilat nuk kanë arritur parashkrimin dhe atë filluar nga fatura F0201033 e datës 28.03.2019 e deri tek fatura F0101033 e datës 31.01.2020.

Gjykata, vlerësoj edhe pretendimet e tjera të debitorit të paraqitura në prapësim, por gjeti se të njëjtat nuk paraqesin bazë për anulimin e urdhrin përmbarimor në kuptim të nenit 71 të LPP-së. Ndërsa, në kuptim të nenit 73 të LPP-së, lidhur me prapësimin e debitorit u vendos jashtë seancës gjyqësore.

Nga arsyet e paraqitura më lart dhe duke u bazuar në nenin 73 të LPP-së, nenin 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.1993/22, datë 29.03.2024.

Gjyqtarja
Vera Gashi Bala

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.